

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Punimet prej 3 muajsh te "Pjetër Budi", banorët: Ku janë trotuaret e projektit?
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1391703.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 07:00:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	15 shtator 2026, 06:54:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 15 shtator 2026, 06:53:00 UTC → 15 shtator 2026, 06:55:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	051f3c33b38862bc311cecbadd0cb64e88582ce8cf465e12bca8cbc7aa55f576
TEKSTI	c2f5454d22590c1c9b46b87b5f657896eea66747316e14b54afce8c187c6cceb
PAMJA	c7c81e4c66fdd26615e49c167b141941a8c4b5bd76f1529c26f8052113180766

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	89aac25c47542018a20f881e10d6d7fa35612599718494c3a3cd07008e3b4428
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	144dcc84d15b7d80530ccf1620af6bb24eccd27028b717aa2669aa241970dde3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/89aac25c47542018a20f881e10d6d7fa35612599718494c3a3cd07008e3b4428>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Punimet prej 3 muajsh te “Pjetër Budi”, banorët: Ku janë trotuaret e projektit?

Shkruar nga: A Shehaj | Publikuar më: 15.09.2026, 08:54



Share



Share



Një banore, e cila ka kërkuar të mbetet anonime, ka ngritur shqetësimin për mënyrën se si po zhvillohen prej më shumë se tre muajsh punimet në rrugën “Pjetër Budi”, në vijim të Qytetit Studenti.

Sipas saj, ndërhyrjet kanë nisur me punime për kanalizimet dhe shtrimin e kabujve, çka ka sjellë gjurmime të përsëritura në rrugë dhe vështirësi të vazhdueshme për banorët. Aktualisht, sipas denoncimit, lëvizja në këmbë është e vështirë për shkak të pluhurit, ndërsa edhe qarkullimi i automjeteve paraqet problem.

Por shqetësimi kryesor lidhet me mënyrën se si po zbatohet projekti i rikonstruksionit të aksit rrugor.

Banorja thotë se projekti parashikon sistemimin e rrugës dhe krijimin e trotuareve, ndërsa në fazat e para të punimeve ishin shënuar me të kuqe disa objekte, mure dhe avli që, sipas saj, do të duhej të spostoheshin për të liruar hapësirat e nevojshme.

“Fillimisht u markuan vendet që do të spostoheshin me të kuqe”, shprehet banorja, duke iu referuar edhe materialeve fotografike të dërguara për denoncimin.

Megjithatë, sipas saj, deri më tani nuk është ndërmarrë asnjë ndërhyrje konkrete për spostimin e këtyre objekteve apo lirin e hapësirave të parashikuara në projekt.

Ndërkohë, banorja ngre pikëpyetje edhe për vendosjen e bordurave, duke pretenduar se ato po vendosen pa u krijuar më parë hapësirat e nevojshme për trotuaret.


Sipas denoncimit, një pjesë e konsiderueshme e rrugës po shtrohet në kushte të ngjashme me gjendjen e mëparshme, ndërsa banorët shqetësohen se nëse hapësirat nuk lirohen, mund të mos realizohet gjerësia e rrugës dhe trotuaret e parashikuara në projekt.

“Me ndërhyrje të disa personave nuk po ndërmerret asnjë hap për spostimin dhe lirin e ambienteve për të realizuar, sipas planit, rikonstruksionin e rrugës”, pretendon banorja.

Ajo kërkon që institucionet përgjegjëse të bëjnë transparente mënyrën e zbatimit të projektit dhe të sqarojnë nëse punimet po kryhen në përputhje me projektin e miratuar dhe standardet përkatëse.

Për banorët, krijimi i trotuareve të aksesueshme shihet si një nevojë thelbësore, veçanërisht për lëvizjen e këmbësorëve në mënyrë të sigurt.

Qytetaria ka kërkuar që shqetësimi të publikohet në identifikuar autorin. Ajo



Më të Lexuarat



ARTIKULL JOETIK?

Gjykatja ka kërkuar që shqetësimi të publikohet pa identifikuar autorin. Ajo sugjeron gjithashtu që situata të verifikohet në terren nga gazetarët dhe, nëse është e nevojshme, të merret edhe një vlerësim nga një ekspert i fushës për të interpretuar projektin dhe për të përcaktuar nëse punimet po zbatohen sipas specifikimeve teknike.









Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.